



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 29.05.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 22.05.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **V.B "INVEST" SHPK. Rr. Vicanium, objekti Redoni k5 nr45, Arbëri Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Asfaltimi i rrugëve në fshatin Lluga", me Nr. të Prok: **613-20- 1359- 521**

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik V.B "INVEST" SHPK. Rruga Vicanium, objekti Redoni kati 5 nr.45, Arbëri Prishtinë të dt. 22.05.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Asfaltimi i rrugëve në fshatin Lluga", me nr. të Prok: 613-20- 1379- 521 dhe nr. Brendshëm 613 020 019 521

1. *Vërtetohet* Vendimi i AK për shpërblim me kontratë, Operatorve Ekonomik Bujar Shabani B.I – Ferizaj i datës 22.05.2020 të publikuar në web-faqe të KRPP-së .
2. *Mbetet në fuqi* Vendimi i AK për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 22.05.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatorëve Ekonomik **VB INVEST SHPK** me datë 22.05.2020 ka parashtruar ankesë lidhur me aktivitetin e prokurimit Asfaltimi i rrugëve në fshatin Lluga, me nr. të Prok, **613-20- 1359- 521** dhe nr. brendshëm 613 020 019 521 **për shpërblim me kontratë**, Operatorin Ekonomik **Bujar Shabani B.I – Ferizaj**, të datës 18.05.2020 te publikuar ne platformen elektronike e-prokurimi.

Operatori Ekonomik V.B "INVEST" SHPK. rruga Vicanium, objekti Redoni k5 nr45, Arbëri Prishtinë të dt. 22.05.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Asfaltimi i rrugëve në fshatin Lluga", me Nr. të Prok: **613-20- 1359- 521**, Autoriteti Kontraktues, me datë 24.05.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dhe konsideron se tenderi juaj është vlersuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP për tenderët jo normalisht të ulët sepse janë plotësuar te tri kushtet për tenderin jo normalisht të ulët.

SHEMBULL

Nr.	Lot 1			
	A	B	C	D
1	kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar më shumë se 3 oferta	Pranuar më shumë se 3 oferta		
2	1	1	54,077.40	
3	2	2	52,648.18	
4	3	3	52,764.14	
5	4	4	70,557.92	
6	5	5	54,232.92	
7	6	6	49,157.40	
8	7	7	41,294.93	
9	8	8	54,014.57	
10	9	9	56,394.83	
8		Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7+C8+C9)	48,5142.29	
9		mesatarja (C8/6)	53,904.67	
10	kushti 2 – pragu 30% në mes të ofertës më të lirë në krahasim me çmimin mesatar të ofertave	pragu 30% (mesatarja /1.3)	41,465.13	ne këtë rast vetëm oferta 7 përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
11	kushti 3 – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	pragu 10% (oferta e dyte /1.1)	45,424.50	ne këtë rast oferta 7 përmbush edhe kushtin e trete

Siq shifet nga tabela e mësipërme, janë të plotësuar tri kushtet që tregojnë se oferta e juaj për këtë aktivitet të prokurimit, ka çmime jonormalisht të ulta.

Edhe çmimet njësi janë tepër të ulta dhe të pa arsyeshme sepse 1m³ gurë vetëm të transportohet 15 km kushton 1€ e jo të blihet të shtrihet të ngjeshet etj. e mos t'përmendim edhe çmimet në pozicionet etjera.

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Adem Duriqi

Drejtor i Prokurimit

